

Classic sh.p.k
Pasqyrat Financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017
Së bashku me Raportin e Audituesit të Pavarur

PËRMBAJTJA:

	FAQE
RAPORTI I AUDITUESIT TË PAVARUR	1
PASQYRAT FINANCIARE:	
PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR	3
PASQYRA E PERFORMANCËS	4
PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË KAPITAL	5
PASQYRA E FLUKSIT TË MJETEVE MONETARE	6
SHËNIMET SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE	7-20

RAPORT I AUDITUESIT TË PAVARUR

Për Menaxhimin dhe ortakët e Shoqërisë Classic shpk

Opinion

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Shoqërisë **Classic shpk** (Shoqëria), të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar më datën 31 Dhjetor 2017, pasqyrën e performancës, pasqyrën e fluksit të mjeteve monetare dhe pasqyrën e ndryshimeve në kapital për vitin e mbyllur në këtë datë, si edhe shënimet për pasqyrat financiare, përfshirë një përmbledhje të politikave kontabël më të rëndësishme.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare bashkëlidhur paraqesin drejt, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Shoqërisë më datën 31 Dhjetor 2017, performancën e saj financiare dhe flukset e parasë për vitin që mbyllet në këtë datë, në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara në Shqipëri.

Baza për Opinionin

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen Përgjegjësitë e Audituesit për Pasqyrat Financiare. Ne jemi të pavarur nga Shoqëria në përputhje me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Shqipëri dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

Përgjegjësitë e Drejtimit dhe të Personave të Ngarkuar me Qeverisjen në lidhje me Pasqyrat Financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara, dhe për ato kontrole të brendshme që drejtimi i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për vlerësimin e aftësisë së Shoqërisë për të vazhduar aktivitetin e saj në bazë të parimit të vijimësisë, shënimet shpjeguese, si edhe për çështjet që lidhen me vazhdimësinë e aktivitetit të shoqërisë, duke përdorur parimet bazë të vazhdimësisë, përveç rastit kur drejtimi ka për qëllim të likuidojë aktivitetin, ose të ndërpresë aktivitetin operacional, ose nuk ka asnjë alternativë tjetër reale përveçse më lart.

Palët e ngarkuara me qeverisjen janë përgjegjëse për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Shoqërisë.

Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare

Objektivat tona janë që të arrijmë një siguri të arsyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston. Anomalitë mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e auditimit në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin dhe skepticizmin tonë profesional gjatë gjithë periudhës së auditimit. Gjithashtu ne:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rrezikun e anomalive materiale në pasqyrat financiare, si pasojë e mashtrimeve apo gabimeve, planifikojmë dhe zbatojmë procedurat përkatëse për zbutjen e këtyre rreziqeve, si edhe marrim evidencë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të krijuar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i moszbulimit të një anomalie si pasojë e mashtrimit është më i lartë se rreziku i moszbulimit të një anomalie si pasojë e gabimit, për shkak se, mashtrimi mund të përfshijë fshehje të informacionit, falsifikim të informacionit, përvetësime të qëllimshme, keqinterpretime, apo shkelje të kontrollit të brendshëm.
- Marrim një kuptueshmëri të atyre kontrolleve të brendshme relevante për procesin e auditimit me qëllim hartimin e procedurave të auditimit në përputhje me rrethanat, por jo për të shprehur një opinion mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e çmuarjeve kontabël të kryera si edhe paraqitjen në shënimet shpjeguese përkatëse të bëra nga Drejtimi.
- Shprehemi në lidhje me përshtatshmërinë e parimit të vijimësisë, bazuar në evidencat e marra gjatë auditimit, mbi ekzistencën e një pasigurie materiale mbi aftësinë e Shoqërisë për të vazhduar në vijimësi aktivitetin e saj. Nëse një pasiguri materiale ekziston, ne duhet të tërheqim vëmendjen në shënimin shpjegues përkatës, nëpërmjet raportit tonë të auditimit, ose nëse shënimet shpjeguese nuk janë të përshtatshme ne duhet të modifikojmë opinionin tonë. Përfundimet tona jepen mbi bazën e evidencës së auditimit të marrë deri më datën e raportit të auditimit. Megjithatë, ngjarjet ose kushtet në të ardhmen mund të shkaktojnë ndërprerje të aftësisë së Shoqërisë për vijimësi.
- Vlerësojmë paraqitjen, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare dhe të shënimeve shpjeguese dhe në rast se ato përfaqësojnë drejt transaksionet dhe ngjarjet.

Ne komunikojmë me personat të ngarkuar për qeverisjen e Shoqërisë, përveçse çështjeve të tjera, edhe objektin dhe kohën e planifikuar të auditimit, gjetjet kryesore të auditimit, përfshirë çdo mangësi relevante në kontrollin e brendshëm të identifikuar gjatë auditimit tonë.



20 qershor 2018

Classic shpk*(Vlerat janë në Lek)***Pasqyra e Pozicionit Financiar
më 31 dhjetor 2017**

	Shënime	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
AKTIVET			
Aktive afatshkurtra			
Mjete monetare	4	1,547,433	4,866,651
Llogari të arkëtueshme tregtare	5	273,616,639	249,376,004
Llogari të arkëtueshme nga palët e lidhura	6	213,670,764	212,742,606
Të tjera llogari të arkëtueshme	7	83,948,618	82,732,243
Inventari	8	71,258,488	69,361,519
Parapagime per furnizime	9	1,883,454	229,343,961
Totali i aktiveve afatshkurtra		645,925,396	848,422,984
Aktivët afatgjatë			
Aktive afatgjatë material	10	451,555,545	486,704,869
Totali i aktiveve afatgjatë		451,555,545	486,704,869
Totali i aktiveve		1,097,480,941	1,335,127,853
DETYRIMET			
Detyrime afatshkurtra			
Hua afatshkurtra	11	441,173,303	470,293,140
Llogari të pagueshme tregtare	12	189,791,485	185,675,437
Llogari të pagueshme ndaj palëve të lidhura	13	77,983,137	79,201,154
Detyrime tatimore	14	1,546,300	2,576,899
Të ardhurat e shtyra	15	224,331,762	371,540,670
Të tjera detyrime		-	10,000
Totali i detyrimeve afatshkurtra		934,825,987	1,109,297,300
Detyrime afatgjatë			
Hua afatgjatë	16	115,434,914	189,650,021
Të tjera detyrime	17	26,581,881	26,804,002
Totali i detyrimeve afatgjatë		142,016,795	216,454,023
Totali i detyrimeve		1,076,842,782	1,325,751,323
Kapitali			
Kapitali i nënshkruar	18	88,000,000	88,000,000
Rezerva statutoare		166,500	166,500
Rezerva ligjore		13,500	13,500
Fitime të mbartura		(78,803,470)	(76,392,658)
Fitimi i ushtrimit		11,261,629	(2,410,812)
Totali i kapitalit		20,638,159	9,376,530
Totali i kapitalit dhe detyrimeve		1,097,480,941	1,335,127,853

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 7 deri në 20, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Pasqyra e Performancës

Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

	Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016
Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit	19	1,644,925,991	1,559,567,404
Të ardhura të tjera të shfrytëzimit	20	10,424,322	10,031,910
Lënda e parë, materiale të konsumueshme		(1,548,245,039)	(1,497,168,650)
1) Lënda e parë, materiale të konsumueshme dhe shpenzime të tjera	21	(1,524,682,962)	(1,470,211,819)
2) Të tjera shpenzime	22	(23,562,077)	(26,956,831)
Shpenzime të personelit	23	(30,947,913)	(30,454,164)
1) Paga dhe shpërblime		(26,800,630)	(26,310,219)
Shpenzime të sigurimeve		(4,147,283)	(4,143,945)
2) shoqërore/shëndetësore			
Shpenzime konsumi dhe amortizimi	10	(27,396,453)	(24,051,647)
Shpenzime të tjera të shfrytëzimit	24	(1,197,211)	(1,901,190)
Shpenzime financiare		(32,422,395)	(15,484,527)
Shpenzime interesi dhe shpenzime të ngjashme	25	(41,267,808)	(24,658,754)
2) Shpenzime të tjera financiare	26	8,845,413	9,174,227
Fitimi/humbja para tatimit		15,141,302	539,136
Shpenzimi i tatimit mbi fitimin		(3,879,673)	(2,949,948)
1) Shpenzimi aktual i tatimit mbi fitimin	27	(3,879,673)	(2,949,948)
2) Shpenzimi aktual i tatimit të shtyrë		-	-
Fitimi/humbja e vitit		11,261,629	(2,410,812)
Të ardhura të tjera gjithpërfshirëse për vitin		-	-
Totali i të ardhurave të tjera gjithpërfshirëse për vitin		-	-
Totali i të ardhurave gjithpërfshirëse për vitin		11,261,629	(2,410,812)

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 7 deri në 20, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Classic shpk

(Vlerat janë në Lek)

**Pasqyra e ndryshimeve në Kapital
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017**

	Kapitali i nënshkruar	Rezerva Ligjore	Rezerva Statutore	Fitimet e Pashpërndara	Fitim / Humbja e vitit	Totali
Pozicioni më 1 janar 2016	88,000,000	13,500	166,500	(76,436,174)	43,516	11,787,342
Fitimi / Humbja e vitit					(2,410,812)	(2,410,812)
Transferim ne fitim/humbje të mbartura				43,516	(43,516)	-
Pozicioni më 31 dhjetor 2016	88,000,000	13,500	166,500	(76,392,658)	(2,410,812)	9,376,530
Fitimi / Humbja e vitit					11,261,629	11,261,629
Transferim ne fitim/humbje të mbartura				(2,410,812)	2,410,812	
Pozicioni më 31 dhjetor 2017	88,000,000	13,500	166,500	(78,803,470)	11,261,629	20,638,159

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 7 deri në 20, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Pasqyrat financiare të Shoqërisë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017 janë aprovuar nga administratori i Classic shpk më _____ dhe janë firmosur si më poshtë:

Z. Artan Qesko
Administrator

Znj. Mimoza Palushi
Drejtores e Financës

Pasqyra e Fluksit të Mjeteve Monetare
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016
Flukset e parasë nga aktivitetet operative		
Fitim / Humbja e vitit	11,261,629	(2,410,812)
<i>Rregullimet për shpenzimet jomonetare:</i>		
Shpenzimet financiare jomonetare	(5,293,882)	(7,224,877)
Shpenzimet për tatimin mbi fitimin jomonetar		
Shpenzime konsumi dhe amortizimi	27,396,453	24,051,647
Zhvlërësimi i aktiveve afatgjata material		
<i>Fluksi i mjeteve monetare i përfshirë në aktivitetet investuese:</i>		
Fitim nga shitja e aktiveve afatgjata materiale	(1,223,230)	(8,791,343)
<i>Ndryshimet në aktivet dhe detyrimet e shfrytëzimit:</i>		
Rënie/(rritje) në të drejtat e arkëtueshme dhe të tjera	201,075,339	(450,770,498)
Rënie/(rritje) në inventarë	(1,896,969)	(189,949)
Rritje/(rënie) në detyrimet e pagueshme	(145,351,597)	465,470,424
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e shfrytëzimit	85,967,743	20,134,592
Fluksi i Mjeteve Monetare nga/(përdorur në) aktivitetin e investimit		
Pagesa për blerjen e aktiveve afatgjata materiale	(742,118)	(49,867,125)
Arkëtime nga shitja e aktiveve afatgjata materiale	9,718,340	39,022,966
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e investimit	8,976,222	(10,844,159)
Fluksi i Mjeteve Monetare nga/(përdorur në) aktivitetin e financimit		
Hua të arkëtuara		
Pagesa e huave	(103,557,065)	(26,296,087)
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e financimit	(103,557,065)	(26,296,087)
Rritje/(rënie) neto në mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare	(8,613,100)	(17,005,654)
Mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare më 1 janar	4,866,651	14,647,428
Efekti i luhatjeve të kursit të këmbimit të mjeteve monetare	5,293,882	7,224,877
Mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare më 31 dhjetor	1,547,433	4,866,651

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 7 deri në 20, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

1. Informacion i përgjithshëm

Shoqëria "Classic" shpk është krijuar në korrik 1999, me vendim gjykatë nr. 21604. Veprimtaria e saj rregullohet sipas dispozitave përkatëse në përputhje me ligjin 9901 datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare". Shoqëria ka NIPT J91909004J.

Shoqëria është një shoqëri shqiptare me ortakë:

- Z. Agron Papuli, zotëron 66.67% të kuotave të kapitalit të shoqërisë
- Z. Artan Qesko, zotëron 33.33% të kuotave të kapitalit të shoqërisë.

Kapitali i shoqërisë është 88,000,000 Lek, i ndarë në 100 kuota me vlerë 880,000 Lek secila. Administrator i shoqërisë është Z. Artan Qesko.

Selia e shoqërisë është në Autostradën Tiranë-Durrës, km 1, rruga dytësore, Godina Nr. 8, Kashar, Tiranë.

Aktiviteti kryesor i kësaj shoqërie, si përfaqësues ekskluziv i firmës "Volkswagen A.G" është tregtimi dhe riparimi i automjeteve të grupit Volkswagen, organizimi i panairove dhe ekspozitave për paraqitjen e automjeteve, dhënia e automjeteve me qira, etj.

Në 31 dhjetor 2017 Shoqëria ka 34 punonjës. (2016: 35).

2. Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare

2.1. Deklarata e pajtueshmërisë

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara (SKK) dhe ligjin nr. 9228, datë 29 prill 2004 "Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare".

Në bazë të urdhrit nr. 64 datë 22.7.2014 "Për shpalljen e Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara dhe zbatimin e detyrueshëm të tyre", Ministria e Financave vendosi të bëjë të detyrueshëm zbatimin e Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara duke filluar nga 1 janar 2015.

Ky urdhër hyri në fuqi me fletoren zyrtare nr.119, datë 1 gusht 2014.

2.2. Bazat e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në koston historike.

2.3. Biznesi në vijimësi

Pasqyrat financiare të Shoqërisë përgatiten mbi supozimin e biznesit në vijimësi, i cili merr parasysh se Shoqëria do të vazhdojë ekzistencën e aktivitetit të saj për një të ardhme të parashikuar.

2.4. Monedha funksionale dhe e paraqitjes

Këto pasqyra financiare janë paraqitur në Lek, e cila është dhe monedha funksionale e Shoqërisë.

2.5. Vlerësime dhe gjykime

Paraqitja e pasqyrave financiare kërkon që manaxhimi i shoqërisë të kryejë vlerësime dhe supozime që ndikojnë shumat e raportuara të aktiveve, detyrimeve dhe aktiveve e detyrimeve të kushtëzuara në datën e pasqyrës së pozicionit financiar, si dhe të ardhurave dhe shpenzimeve të krijuara në periudhën kontabël.

Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen vazhdimisht dhe bazohen në eksperiencën e mëparshme dhe faktorë të tjerë duke përfshirë pritshmëritë për ngjarjet e ardhshme të cilat besohen të jenë të arsyeshme në rrethanat aktuale. Në disa raste manaxhimi mbështetet në mendimet e ekspertëve të pavarur. Manaxhimi kryen vlerësime dhe gjykime në lidhje me të ardhmen. Vlerësimet kontabël që rezultojnë sipas përkufizimit, jo gjithmonë do të barazohen me rezultatet aktuale. Vlerësimet dhe supozimet që kanë risk të rëndësishëm për të shkaktuar korrigjime (axhustime) materiale të vlerave të mbartura të aktiveve dhe detyrimeve, janë përshkruar më poshtë:

2. Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare (vazhdim)**2.5.1. Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme**

Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme bazohet në humbjet e vlerësuar, të cilat rezultojnë nga pamundësia e konsumatorëve për të paguar detyrimet e tyre. Këto vlerësime bazohen në moshën e llogarive të arkëtueshme dhe eksperiencën e mëparshme në ç'regjistrimin, vlerësimin e aftësisë paguese të konsumatorëve, si dhe ndryshimet e fundit dhe të pritshme të termave të pagesës së konsumatorëve. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për zhvlerësimin e llogarive të arkëtueshme.

2.5.2. Provizionet

Provizionet në përgjithësi kërkojnë një nivel të lartë gjykimi, veçanërisht në rastet e konflikteve gjyqësore. Shoqëria vlerëson mundësinë e krijimit të një detyrimi aktual si rrjedhojë e një ngjarjeje të shkuar, në rast se mundësia e ndodhjes vlerësohet të jetë më shumë se 50%. Në të tilla raste shoqëria provizionon vlerën e detyrimit, e cila mund të matet me besueshmëri. Për shkak të nivelit të lartë të pasigurisë, në disa raste mund të ndodhë që vlerësimi mund të mos jetë në të njëjtën linjë me rezultatin e çështjes. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për krijimin e provizioneve.

2.6. Krahasueshmëria e informacionit kontabël

Siç paraqitet në Standardin Kombëtar të Kontabilitetit të përmirësuar nr. 1, në rastet e një ndryshimi në paraqitjen e pasqyrave financiare si pasojë e kërkesave të një standardi të ri, një përmirësimi në standard apo një ndryshimi në ligjin "Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare", informacioni krahasues duhet të riparaqitet për të korresponduar me paraqitjen e re, përveç rasteve kur riparaqitja e informacionit krahasues nuk mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme.

3. Politikat Kontabël

Politikat kontabël të mëposhtme janë aplikuar në mënyrë konsistente në të gjitha periudhat e paraqitura në pasqyrat financiare.

3.1. Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale dhe regjistrohen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Aktivët dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e raportimit konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e bilancit. Fitimi ose humbja nga këmbimi në zëra monetarë është diferenca që vjen nga këmbimi i një numri të caktuar njësisht të një monedhe të huaj në monedhën funksionale me kurse të ndryshme këmbimi në datat e këmbimit. Të drejtat dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës së kryerjes së transaksionit, ndërsa ato që maten me vlerë të drejtë rikëmben në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës kur është përcaktuar vlera e drejtë. Diferencat që rezultojnë nga kursi i këmbimit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Kursi i këmbimit i monedhave të huaja më 31 dhjetor 2017 dhe 2016 është detajuar si më poshtë:

Kursi i këmbimit	2017	2016
EUR/Lek	132.95	135.23
USD/ Lek	111.10	128.17

3. Politikat Kontabël (vazhdim)

3.2. Instrumentat financiarë

Instrumentat financiarë jo-derivativë përbëhen nga llogari të arkëtueshme, mjete monetare, hua të marra dhe të dhëna dhe llogari të pagueshme.

Instrumentat financiarë jo-derivativë njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus çdo kosto transaksioni që lidhet me to, përveç siç përshkruhet më poshtë. Për instrumentat e mbajtur me vlerë të drejtë nëpërmjet fitim/humbjes, kostot e transaksionit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Në vijim të njohjes fillestare, instrumentat financiarë jo-derivativë maten siç përshkruhet më poshtë.

Një instrument financiar njihet nëse Shoqëria bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit. Aktivet financiare ç'regjistrohen kur skadojnë të drejtat kontraktuale të shoqërisë mbi flukset e parasë së aktivitetit financiar ose kur shoqëria transferon aktivin financiar tek një palë e tretë pa mbajtur kontrollin ose gjithë risqet dhe përfitimet thelbësore të aktivitetit. Blerjet dhe shitjet normale të aktiveve financiare kontabilizohen në datën e transaksionit, që është data në të cilën shoqëria angazhohet të blejë apo të shesë aktivin. Detyrimet financiare ç'regjistrohen nëse detyrimet kontraktuale të shoqërisë skadojnë, shfuqizohen ose anulohen.

Mjetet monetare

Mjetet monetare përfshijnë arkën, llogaritë rrjedhëse dhe depozitat në të parë me bankat. Për qëllimin e pasqyrës së fluksit të parasë, mjetet monetare përfshijnë depozita me afat me një maturim prej tre muajsh ose më pak që nga data e fillimit.

Llogari të arkëtueshme

Llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar, duke zbritur humbjen nga zhvlerësimi. Provizionit për zhvlerësimin e aktiveve të arkëtueshme llogaritet kur ka të dhëna se shoqëria nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha detyrimet. Vështirësitë financiare të debitorit, mundësia që debitori të falimentojë ose riorganizimi i tij financiar, konsiderohen tregues që llogaritë e arkëtueshme të zhvlerësohen. Shuma e provizionit llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë, të skontuara me normën efektive të interesit.

Llogari të pagueshme

Llogaritë e pagueshme paraqiten me vlerën e tyre të drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar, duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Hua të marra dhe të dhëna

Huatë e marra dhe të dhëna njihen fillimisht dhe mbahen në vazhdim me vlerën e tregut, pa përfshirë koston e transaksioneve. Pas njohjes fillestare, huatë e marra dhe të dhëna paraqiten me kosto të amortizuar, duke njohur në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve çdo diferencë midis kostos dhe vlerës së pagueshme nominale përgjatë periudhës së huamarrjes, duke u bazuar (si rregull) në interesin efektiv. Interësat e njohura në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve janë përlllogaritur mbi bazën e interesit nominal.

Vlera e drejtë

Vlerat e drejta të përlllogaritura të mjeteve monetare dhe ekuivalentëve të tyre, të kërkesave për t'u arkëtuar, detyrimeve për t'u paguar dhe huave, përafrohen me vlerat e tyre kontabël.

Të tjera

Instrumenta të tjerë jo-derivativë maten me kosto të amortizuar, sipas metodës së interesit efektiv, duke zbritur çdo humbje nga zhvlerësimi.

3. Politikat Kontabël (vazhdim)

3.2. Instrumentat financiare (vazhdim)

Kapitali themeltar

Kapitali themeltar njihet me vlerën nominale.

Zhvlerësimi i aktiveve financiare

Një aktiv financiar konsiderohet i zhvlerësuar nëse ka të dhëna objektive që tregojnë se një apo disa ngjarje kanë efekte negative në flukset e ardhshme që parashikohet të burojnë nga aktivi.

Një zhvlerësim në lidhje me aktivin financiar, të matur me kosto të amortizuar, llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Aktivet financiare të rëndësishme testohen për zhvlerësim në mënyrë individuale. Aktivët e tjera financiare vlerësohen në mënyrë të grupuar, në grupe që kanë karakteristika të ngjashme të riskut kreditor.

Të gjitha humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Një humbje nga zhvlerësimi rimerret nëse rimarrja mund të lidhet objektivisht me një ngjarje të ndodhur pas njohjes së humbjes nga zhvlerësimi. Për aktivet financiare të matura me kosto të amortizuar, rimarrja njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

3.3. Inventarët

Inventarët regjistrohen në kontabilitet me kosto. Kosto e marrjes përfshin të gjitha shpenzimet e kryera për ta sjellë inventarin në vendin dhe kushtet ekzistuese. Në rastin e prodhimit të produkteve në kosto përfshihet edhe pjesa respektive e shpenzimeve të përgjithshme, duke u llogaritur mbi kapacitetet normale prodhuese. Kosto e inventarit llogaritet duke përdorur metodën e mesatares së ponderuar.

Gjendjet e inventarit janë të vlerësuara në bilanc me koston e tyre historike, duke e konsideruar këtë vlerësim, si vlerën më të ulët midis koston dhe vlerës neto të realizueshme.

3.4. Aktive afatgjata materiale

i. Njohja dhe matja

Të gjitha aktivet afatgjata materiale paraqiten me kosto, duke zbritur zhvlerësimin dhe amortizimin e akumuluar. Kostoja përfshin shpenzime, të cilat lidhen drejtpërdrejt me blerjen e aktivit. Kostoja e aktiveve të vetë-ndërtuara përfshin koston e materialeve dhe punës direkte, çdo kosto tjetër të lidhur drejtpërdrejt me sjelljen e aktivit në gjendje pune për qëllimin e synuar të përdorimit, si dhe koston e ç'montimit, heqjes së pjesëve dhe sjelljes në gjendjen e mëparshme të vendndodhjes së aktivit. Shpenzimet kapitale të aktiveve të bëra gjatë ndërtimit kapitalizohen në "ndërtim në proces" dhe transferohen në kategorinë përkatëse të aktivit kur përfundon ndërtimi tij, nga kur aplikohet amortizimi përkatës sipas kategorisë.

Në rastet kur pjesë të një aktivi afatgjatë material kanë jetëgjatësi të ndryshme, ato kontabilizohen si zëra të ndryshëm (komponentët më të mëdhenj) të aktiveve afatgjata materiale.

Fitimet dhe humbjet nga shitjet, apo nxjerrjet jashtë përdorimit përcaktohen duke krahasuar vlerën e shitjes me vlerën e mbetur dhe këto përfshihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

ii. Kostot e mëpasshme

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të një zëri të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën kontabël të atij zëri nëse është e mundshme që shoqëria do të realizojë përfitime të ardhshme ekonomike nga përdorimi i pjesës zëvendësuese dhe kostoja e pjesës mund të matet në mënyrë të besueshme. Kostot e shërbimeve të zakonshme të aktiveve afatgjata materiale njihen si shpenzim kur ato ndodhin.

3. Politikat Kontabël (vazhdim)**3.4. Aktive afatgjata materiale (vazhdim)***iii. Amortizimi*

Amortizimi i aktiveve llogaritet duke përdorur metodën e vlerës së mbetur të amortizimit mbi jetën e vlerësuar të çdo pjese të aktivitetit afatgjatë material, duke filluar nga dita e parë e muajit që pason muajin e blerjes. Aktivitetet e marra me qira amortizohen duke marrë për bazë periudhën më të shkurtër midis periudhës së qirasë dhe jetës së dobishme të aktivitetit.

Jetëgjatësia e vlerësuar për vitin 2017 dhe 2016 është si më poshtë:

Kategoria e aktiveve	Metoda e Amortizimit	Norma e Amortizimit
Ndërtesa	Vlerë e mbetur	5%
Makineri e Pajisje	Vlerë e mbetur	20%
Mjete Transporti	Vlerë e mbetur	20%
Pajisje Zyre	Vlerë e mbetur	20%
Pajisje Kompjuterike	Vlerë e mbetur	25%
Të tjera	Vlerë e mbetur	20%

iv. Ç'regjistrimi

Një zë i aktiveve afatgjata materiale ç'regjistrohet kur ai nxirret jashtë përdorimit apo atëherë kur nuk priten më përfitime ekonomike të ardhshme nga përdorimi apo nxjerrja e tij jashtë përdorimit.

Fitimet dhe humbjet në rastin e nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve afatgjata materiale, përcaktohen sipas shumës së tyre të mbetur dhe merren parasysh në nxjerrjen e rezultatit operativ të vitit.

3.5. Të ardhurat

Të ardhurat njihen atëherë kur është e mundshme që njësia ekonomike do të ketë përfitime ekonomike në të ardhmen dhe këto përfitime mund të maten me besueshmëri. Të ardhurat maten me vlerën e drejtë të arkëtuar ose të arkëtueshme që merr parasysh shumën e çfarëdo zbritjeje tregtare, zbritjet për shlyerje të menjëhershme dhe zbritjet e bëra për sasi (vëllim) të blerë.

Të ardhurat janë përfitimet ekonomike bruto (pa TVSH dhe zbritjet tregtare) të marra gjatë periudhës kontabël, si rezultat i rrjedhës normale të veprimtarisë së njësies ekonomike raportuese, atëherë kur këto përfitime ekonomike çojnë në rritjen e kapitaleve të veta.

3.6. Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit

Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit paraqesin të ardhurat që përfitohen jo rregullisht gjatë rrjedhës normale të veprimtarisë ekonomike duke përfshirë, fitim/humbjet nga shitja e aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale, fitim/humbjet nga rivlerësimet e aktiveve afatgjata të investuara dhe fitim/humbjet që vijnë nga ndryshimi i kursit të këmbimit, përveç diferencave të këmbimit që lidhen me veprimtaritë financiare dhe investuese.

3.7. Qiratë

Qiramarrjet klasifikohen si financiare ose operative që në fillimin e qirasë. Qiratë financiare njihen si aktive dhe detyrime financiare në shkallën më të ulët të vlerës së drejtë të aktivitetit dhe vlerës aktuale të minimumit të pagesave të qirasë në datën e blerjes. Kostot financiare regjistrohen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve nën termin e qirasë, me normat e zbatueshme të interesit mbi balancën e mbetur të detyrimeve.

3. Politikat Kontabël (vazhdim)**3.8. Të ardhurat dhe shpenzimet financiare**

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhura interesi nga llogaritë bankare dhe fitime nga kursi i këmbimit, që njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Të ardhurat nga interesi njihen mbi bazën e të drejtave të konstatuara, duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzime interesi mbi huamarrjet dhe humbjet nga kursi i këmbimit, ndryshimet në vlerën e drejtë të aktiveve financiare të mbajtura me vlerë të drejtë nëpërmjet llogarisë fitim/humbje dhe humbjet nga zhvlerësimi i aktiveve financiare. Kostot e huamarrjes njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve me metodën e interesit efektiv.

3.9. Tatimi mbi fitimin

Tatim fitimi i vitit përbëhet nga tatimi aktual dhe tatim fitimi i shtyrë. Tatim fitimi njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve, përveç rasteve kur lidhet me zëra që njihen direkt në kapital, rast në të cilin edhe tatimi njihet në kapital.

Tatimi aktual është tatimi i pritur për t'u paguar mbi fitimin e tatueshëm të vitit, duke aplikuar normat tatimore në fuqi në datën e bilancit, si dhe çfarëdolloj rregullimi kontabël të tatimit për t'u paguar në lidhje me vitet e mëparshme. Norma e tatimit mbi fitimin për vitin 2017 është 15% (2016: 15%).

Tatim fitimi i shtyrë përfaqëson diferencën e tatimit mbi fitimit të pagueshëm (apo të rikuperueshëm) në periudhat e ardhshme, i cili përlllogaritet për të evidentuar diferencat e përkohshme që krijohen për shkak të aplikimit të parimeve kontabël të ndryshme nga ato tatimore. Tatimi i shtyrë njihet sipas metodës së detyrimeve të bilancit, duke aplikuar normën tatimore në fuqi mbi diferencën ndërmjet aktiveve dhe detyrimeve për qëllime të raportimit financiar dhe vlerave të këtyre aktiveve dhe detyrimeve për qëllime tatimore.

Gjendjet e shtyra tatimore maten me normat tatimore në fuqi ose që konsiderohen në fuqi në fund të periudhës së raportimit, të cilat pritet të zbatohen për periudhën kur diferencat e përkohshme do të anulohen ose humbja tatimore e mbartur do të shfrytëzohet.

Aktivet tatimore të shtyra për diferencat e përkohshme të zbritshme regjistrohen deri në atë masë që është e mundshme që fitimi i tatueshëm në të ardhmen të mund të përdoret për zbritjet në fjalë.

3.10. Fondet për pensione

Shoqëria paguan kontributet ndaj sigurimeve shoqërore e shëndetësore të detyrueshme, që sigurojnë përfitimet për pensione të punonjësve në përputhje me legjislacionin shqiptar. Autoritetet Fiskale janë përgjegjëse për përcaktimin e kufirit minimal ligjor, të vendosur për pensionet në juridiksionin përkatës sipas një plani kontributësh pensioni të përcaktuar.

3.11. Transaksionet me palët e lidhura

Palët e lidhura përcaktohen kur një palë kontrollohet nga pala tjetër ose ka ndikim të rëndësishëm në vendimet e biznesit apo vendimet financiare të palës tjetër. Për qëllime të paraqitjes së pasqyrave financiare, drejtimi i shoqërisë dhe manaxhimi konsiderohen si palë të lidhura.

3.12. Provizionet

Një provizion njihet nëse, si rezultat i një ngjarjeje të shkuar, Shoqëria ka një detyrim ligjor apo konstruktiv, i cili mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme dhe do të kërkojë në të ardhmen flukse dalëse parash për shlyerjen e tij. Provizionet përcaktohen duke skontuar flukset e pritshme të ardhshme të parasë me një normë skontimi para tatimit që pasqyron vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe për risqet që lidhen me detyrimin në fjalë. Provizionet rishikohen në çdo datë raportimi dhe nëse nuk ka më gjasa për daljen e ndonjë fluksi parash për shlyerjen e detyrimit, provizionet rimerren.

3. Politikat Kontabël (vazhdim)**3.13. Aktivët dhe detyrimet e kushtëzuara**

Detyrimet e kushtëzuara nuk njihen në pasqyrat financiare. Ato paraqiten në shënime të pasqyrave financiare për sa kohë që mundësia për një dalje të burimeve që përfshijnë përfitime ekonomike është e largët. Një aktiv i kushtëzuar nuk paraqitet në pasqyrat financiare, por paraqitet në shënime, për sa kohë ekziston mundësia e hyrjes së përfitimeve ekonomike. Shuma e humbjeve të kushtëzuara njihet si provizion, nëse është e mundshme që ngjarjet e ardhshme të konfirmojnë që një detyrim ka lindur në datën e pozicionit financiar dhe mund të bëhet një vlerësim i arsyeshëm i shumës së humbjes.

4. Mjete monetare

Mjetet monetare në arkë dhe bankë detajohen si më poshtë më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016:

	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
Mjete monetare në bankë dhe llogari të tjera	1,503,859	4,850,966
Në lekë	963,974	3,107,620
Në monedhë të huaj	375,265	1,743,346
Garanci bankare	164,620	-
Mjete monetare në arkë	43,574	15,685
	1,547,433	4,866,651

5. Llogari të arkëtueshme tregtare

Llogaritë e arkëtueshme tregtare më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016 paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
Klientë për shitje makinash	178,835,960	175,378,888
Klientë për shitje pjesësh këmbimi	42,557,593	27,528,579
Klientë Leasing Qira	51,790,793	45,691,915
Të tjera	432,293	776,622
	273,616,639	249,376,004

6. Llogari të arkëtueshme nga palët e lidhura

Llogaritë e arkëtueshme nga palët e lidhura më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016 paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
Të drejta dhe detyrime ndaj ortakëve	151,772,520	154,662,745
Hua të dhëna palëve të lidhura	61,898,244	58,079,861
	213,670,764	212,742,606

7. Të tjera llogari të arkëtueshme

Të tjera llogari të arkëtueshme më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016 paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
Tatim fitimi i mbipaguar	-	810,149
TVSH e arkëtueshme	1,935,595	-
Te tjera të arkëtueshme	82,013,023	81,922,094
	83,948,618	82,732,243

8. Inventari

Inventari më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016 paraqitet si me poshtë:

	<u>31 dhjetor 2017</u>	<u>31 dhjetor 2016</u>
Makina	16,352,109	12,363,385
Pjesë këmbimi	54,906,379	56,998,134
	<u>71,258,488</u>	<u>69,361,519</u>

9. Parapagime dhe shpenzime të periudhave të ardhshme

Parapagimet dhe shpenzimet e shtyra paraqiten si më poshtë më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016:

	<u>31 dhjetor 2017</u>	<u>31 dhjetor 2016</u>
Parapagime dhe shpenzime të shtyra	1,883,454	1,937,578
Parapagime për mallra eksporti	-	227,406,383
	<u>1,883,454</u>	<u>229,343,961</u>

10. Aktive Afatgjata Materiale

Kosto

Gjendja më 1 janar 2016	385,000,000	51,156,000	256,809,377	16,114,567	10,198,534	8,478,951	727,757,429
Shtesa	20,000,000	31,358	29,133,040	99,834	543,213	59,680	49,867,125
Nxjerrje jashtë përdorimit			(67,797,094)				(67,797,094)
Gjendja më 31 dhjetor 2016	405,000,000	51,187,358	218,145,323	16,214,401	10,741,747	8,538,631	709,827,460

Shtesa

Nxjerrje jashtë përdorimit	-	355,604	325,728	-	-	60,786	742,118
	-	(1,799,132)	(24,780,978)	-	-	-	(26,580,110)
Gjendja më 31 dhjetor 2017	405,000,000	49,743,830	193,690,073	16,214,401	10,741,747	8,599,417	683,989,468

Zhvlerësimi i akumuluar

Gjendja më 1 janar 2016	20,486,250	42,846,501	146,141,609	13,253,918	8,771,763	5,136,374	236,636,415
Amortizimi i vitit	-	1,368,721	21,511,296	491,955	333,185	346,490	24,051,647
Nxjerrje jashtë përdorimit	-	-	(37,565,471)	-	-	-	(37,565,471)
Gjendja më 31 dhjetor 2016	20,486,250	44,215,222	130,087,434	13,745,873	9,104,948	5,482,864	223,122,591

Amortizimi i vitit

Nxjerrje jashtë përdorimit	8,000,000	1,127,694	17,213,215	403,041	361,921	290,582	27,396,453
	-	(718,678)	(17,366,443)	-	-	-	(18,085,121)
Gjendja më 31 dhjetor 2017	28,486,250	44,624,238	129,934,206	14,148,914	9,466,869	5,773,446	232,433,923

Vlera neto kontabël

Gjendja më 31 dhjetor 2016	384,513,750	6,972,136	88,057,889	2,468,528	1,636,799	3,055,767	486,704,869
Gjendja më 31 dhjetor 2017	376,513,750	5,119,592	63,755,867	2,065,487	1,274,878	2,825,971	451,555,545

11. Hua afatshkurtër

Huatë afatshkurtëra më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016 paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
Huamarrje afatshkurtra nga bankat	441,173,303	470,293,140
	441,173,303	470,293,140

12. Llogari të pagueshme tregtare

Llogaritë e pagueshme tregtare më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016 paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
Furnitorë për blerje mallrash dhe shërbimesh	33,420,940	24,448,566
Parapagime nga furnitorët	156,370,545	161,226,871
	189,791,485	185,675,437

13. Llogari të pagueshme ndaj palëve të lidhura

Llogaritë e pagueshme ndaj palëve të lidhura më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016 paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
Të pagueshme ndaj palëve të lidhura	77,983,137	79,201,154
	77,983,137	79,201,154

14. Detyrime tatimore

Detyrimet tatimore për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016 detajohen si më poshtë:

	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
Sigurime shoqërore e shëndetësore	1,101,974	1,023,308
TVSH për t'u paguar	-	1,553,591
Tatim fitimi	444,326	-
	1,546,300	2,576,899

15. Të ardhurat e shtyra

Të ardhurat e shtyra për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016 detajohen si më poshtë:

	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
Paradhënie të marra për eksportet	224,331,708	371,540,670
Të ardhura të periudhave të ardhshme	54	-
	224,331,762	371,540,670

16. Hua afatgjata

Huatë afatgjata për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016 detajohen si më poshtë:

	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
Huamarrje nga bankat	115,434,914	189,650,021
	115,434,914	189,650,021

17. Të tjera detyrime

Të tjera detyrime për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016 detajohen si më poshtë:

	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
Të tjera hua afatgjata të dhëna të tretëve	26,581,881	26,804,002
	26,581,881	26,804,002

18. Kapitali

Kapitali për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016 detajohet si më poshtë:

	31 dhjetor 2017		31 dhjetor 2016	
	Vlera	Nr i kuotave	Vlera	Nr i kuotave
Z. Agron Papuli	58,669,600	66.67	58,669,600	66.67
Z. Artan Qesko	29,330,400	33.33	29,330,400	33.33
Totali	88,000,000	100.00	88,000,000	100.00

19. Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit

Të ardhurat nga aktiviteti i shfrytëzimit detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016
Nga shitja e makinave të eksportit	1,302,897,391	1,294,878,939
Nga shitja e makinave brenda vendit	193,910,146	124,560,035
Nga shitja e pjesëve të këmbimit	60,157,361	58,835,586
Nga makinat me qira e Leasing	66,994,604	62,442,891
Nga riparime dhe shërbime	20,966,489	18,849,953
	1,644,925,991	1,559,567,404

Rakordimi i të ardhurave me FDP-në:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017
Rakordimi i të ardhurave me FDP-në	
Qarkullim i tatueshëm	1,663,843,463
Shuma e qarkullimit e korrektuar	1,663,843,463
Të ardhura të shfrytëzimit	1,655,350,313
Vlera kontabel e aktive afatgjata të shitura	8,495,110
Diferenca të tjera	(1,960)
	1,663,843,463

20. Të ardhura të tjera të shfrytëzimit

Të ardhura të tjera të shfrytëzimit detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016
Rezultati nga shitja e AAM-ve*	1,223,230	8,791,343
Të tjera	9,201,092	1,240,567
	10,424,322	10,031,910
<i>Rezultati nga shitja e AAM-ve:</i>		
Nga shitja e AAM-ve	9,718,340	39,022,966
Kosto e AAM-ve të shitura	(8,495,110)	(30,231,623)
	1,223,230	8,791,343

21. Lënda e pare, shërbime dhe materiale të konsumueshme

Në këtë zë paraqiten kostoja e mallrave, lëndeve të para dhe shërbimeve të konsumuara që lidhen me veprimtarinë e shfrytëzimit, të cilat detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016
Shpenzime makina për eksport	1,219,520,438	1,231,352,207
Mallra makina	178,844,453	115,818,915
Mallra dhe pjesë këmbimi	54,890,295	51,875,838
Qira ambjenti dhe makina	39,186,756	40,826,668
Materiale dhe riparime të ndryshme	10,878,300	10,915,153
Karburant për makinat e shitura dhe gjenerator	1,381,508	1,312,797
Siguracione dhe shpenzime për targat e makinave	4,432,532	5,242,654
Shpenzime të shërbimeve doganore	1,418,133	1,349,735
Shpenzime transporti	11,658,983	9,512,680
Riparime, pjese makina garanci dhe brenda çmimit	499,571	257,432
Tarifa doganore	1,971,993	1,747,740
	1,524,682,962	1,470,211,819

22. Të tjera shpenzime

Shpenzimet e tjera detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016
Taksa vendore	2,871,718	2,154,024
Shpenzime të ndryshme të pazbritshme	7,751,908	14,012,947
Konsulencë juridike e ekonomike	1,603,800	1,631,204
Kancelari e noterizime	739,081	751,539
Energji elektrike dhe ujë	1,758,469	1,756,850
Rojeve civile	83,333	1,000,000
Shpenzime telefoni e postare	2,382,344	1,609,131
Udhëtime e dieta	419,432	891,998
Të tjera	2,205,940	1,061,223
Sherbime bankare	1,134,265	1,285,610
Materiale pastrimi	226,732	206,517
Reklama	2,385,055	595,788
	23,562,077	26,956,831

23. Shpenzime të personelit

Shpenzimet e personelit detajohet si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016</u>
Shpenzime për paga	26,800,630	26,310,219
Shpenzime për sigurime shoqërore e shëndetësore	4,147,283	4,143,945
	<u>30,947,913</u>	<u>30,454,164</u>

24. Shpenzime të tjera të shfrytëzimit

Shpenzime të tjera të shfrytëzimit detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016</u>
Gjoha dhe penalitete	1,197,211	1,901,190
	<u>1,197,211</u>	<u>1,901,190</u>

25. Shpenzime interesi dhe shpenzime të ngjashme

Shpenzime interesi dhe shpenzime të ngjashme detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016</u>
Të ardhura nga interest	521,286	292,100
Shpenzime interesi	(40,183,904)	(22,253,136)
Komisione	(1,605,190)	(2,697,718)
	<u>(41,267,808)</u>	<u>(24,658,754)</u>

26. Shpenzime të tjera financiare

Shpenzime të tjera financiare detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016</u>
Të ardhura nga diferencat e kurseve të kembimit	15,685,440	14,479,609
Shpenzime nga diferencat e kurseve të kembimit	(6,840,027)	(5,305,382)
	<u>8,845,413</u>	<u>9,174,227</u>

27. Shpenzimi i tatimit mbi fitimin

Përlogaritja e shpenzimit për tatimin mbi fitimin paraqitet më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016:

	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
<i>Fitimi para tatimit</i>	15,141,302	539,136
Shpenzime të panjohura të tjera si më poshtë	10,723,187	19,127,181
Shpenzime udhëtimi	-	891,998
Penalitete, gjoba e dëmshpërblime	1,197,211	1,901,190
Shpenzime të tjera	7,751,908	14,653,846
Interesa të panjohura	1,774,068	1,680,147
Fitimi para tatimit (përfshirë shpenzimet e panjohura)	25,864,489	19,666,317
Humbje fiskale e mbartur	-	-
Tatim fitimi @15%	3,879,673	2,949,948
Fitimi/humbja e Vitit	11,261,629	(2,410,812)

28. Ngjarje pas bilancit

Nuk ka asnjë ngjarje pas datës së bilancit e cila kërkon rregullime apo shpjegime në këto pasqyra financiare.

